

Fakulteti i Shkencave Mjekësore
Programi Studimor-Biomedicinë
Cikli i tretë i studimeve të Doktoraturës

Fakultetit të Shkencave Mjekësore
Këshillit Mësimor Shkencor të FSHM-së
Tetovë

Në bazë të Vendimit të datës 30.12.2019 për vlerësimin e punimit të disertacionit të doktoraturës të kandidatit **Veton Ademi** të miratuar nga *Këshilli-Mësimor Shkencor i Fakultetit të Shkencave Mjekësore të Universitetit të Tetovës*, u formua **Komisioni për vlerësimin e punimit të disertacionit të doktoraturës të kandidatit Veton Ademi** në përbërje: **Prof. Dr.Sadi Bexheti, Prof. Dr Nexhbedin Beadini, Prof. Dr. Nasir Bexheti, Prof.dr Kastriot Haxhirexha, Prof. Dr. Lutfi Zylbeari**. Komisioni për vlerësimin e punimit të disertacionit të doktoraturës pas shqyrtimit të kërkesës të kandidatit **Veton Ademi** paraqet këtë:

Raport

për vlerësimin e punimit të disertacionit të doktoraturës të kandidatit **Veton Ademi** me titull:

“Karakteristikat antropometrike të fëmijëve dhe të të rinjve në rajonin e Pollogut”

Punimi i disertacionit të doktoraturës së kandidatit **Veton Ademi** si në aspektin stukturor po ashtu edhe në aspektin përmbajtësor dhe hulumtues-shkencor i plotëson kriteret e një punimi të mirëfilltë të doktoraturës.

Punimi i disertacionit të doktoraturës është i konceptuar në *Kapituj* dhe *Nënkapituj* dhe në kuadër të punimit janë përfshi: *158 faqe, 20 tabela, figura 28 dhe 33 grafikone*.

Punimi i disertacionit të doktoraturës së kandidatit **Veton Ademi** është i strukturuar për nga aspekti përmbajtësor dhe metodologjik në: *Hyrje, Materiali dhe metoda e punës, Qëllimi i punës, Rezultatet, Diskutimi, Përfundimi, Summary dhe Literatura*.

I. HYRJA

Tek „Hyrja,, kandidati **Veton Ademi** ka paraqet në mënyrë të thuktë problematikën kryesore të disertacionit të doktoraturës duke përshkruar tematika të problematikës së punimit të disertacionit të doktoraturës dhe ka cituar literaturë të shkëputur nga tematika e fushës përkatëse dhe të fushës së ngushtë të kësajë lëmijë shkencore hulumtuese.

Lënda e hulumtimit që kandidati shtjellon dhe hulumton në tezën e tij të doktoratës, përveç rëndësisë së madhe fundamentale, ka edhe rëndësi të madhe praktike në shumë lëmi, për shkak të përcjelljes së rritjes dhe zhvillimit normal të fëmijëve dhe të rinjve në Rajonin e Pollogut.

Mbi rëndësinë fundamentale ka shumë çka të diskutohet, por për këtë rast do të theksojmë se sot një vend qendror në antropologji i takon zhvillimit bashkëkohorë biologjik, i cili mund të përcillet dhe të studiohet në bazë të treguesve të fituar antropologjik (rezultate të fituara antropologjike). Në edukim dhe arsimim mundësohet planifikim normal dhe përcjellje e të gjitha ngecjeve në pikëpamje të rritjes dhe zhvillimit e qëidentifikimi me kohë do të mundëson te përpunimin diagnostik me qëllim të shmangies së shkaqeve të ndryshme të ngecjes në rritje dhe zhvillim.

Poashtu rëndësi ka edhe përpunimi i “normogramit të rritjes” për nevojat e praktikës mjekësore dhe ndërmarrja e masave terapeutike në përmisimin e rritjes dhe zhvillimit fizik si dhe psikik dhe social, nëqoftë se tefëmijëtidentifikohetngecjenërritjedhezvillim.

Rëndësia shëndetësore qëndron edhe në identifikimin e rasteve me mbi peshë dhe obezitet si faktorë të rëndësishëm në planifikimin dhe ndërmarrjen e masave parandaluese për pengimin e shfaqjes së shumë sëmundjeve që janë në lidhshmëri me mbipeshëndheobezitetin. Këtosëmundjemundtëshfaqennëmoshënfëmijëroreapomëvonënmoshën e rriturtëkëtyrefëmijëvesi: diabet mellitus, çrregullimetëshumtaendokrinologjike, sëmundjet e zemrës dhe nëvetëgjakut.

Të dhënat e fituar janë rëndësi për përdorim në mbrojtjen e popullatës për shkak të njohjes së dinamikës të rritjes së njeriut si dhe përshtatjen ergonomike të makinave, mjeteve të punës, veshëmbathjes në të gjitha vendet e veprimtarisë së tij.

Të dhënat antropometrike do të mundësojnë qasjen e rregullt (normale) të përshtatjes së njeriut në të gjitha vendet e veprimtarisë së tij:

- Në lëmitë e kulturës fizike do të mundësoj seleksionimin, përcjelljen e zhvillimit dhe përmirsimin e aftësive trupore të individit dhe kolektivit;
- Në industrinë e tekstit, konfeksionit, këpucëve dhe industrive tjera do të mundësoj qasjen në masat antropometrike të rinjëve në moshë të ndryshme, të dy gjinive;
- Në industrinë e mobiljeve dhe automobilave do të sigurojë planifikimin e rregullt të dimensioneve në prodhimin tyre.

II. QËLLIMI I PUNIMIT

Tek „ **Qëllimi i hulumtimit,**” kandidati **Veton Ademi** paraqet në mënyrë të thuktë problematikën kryesore të qëllimit të punimit të disertacionit të doktoraturës duke përshkruar qëllimin esencial të fushës shkencore hulumtuese të këtij punimi. Sidomos fokusimi i qëllimit të punimit është mbështetur në problematikën e fushës së antropologjisë dhe sidomos në fushën e antropometrisë.

Me anë të hulumtimeve të këtij lloji, kandidati:

- Ka bërë përpunimin e hartës antropologjike të fëmijëve dhe rinisë në Rajonin e Pollogut, rajon ku mungojnë të dhënat për rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve dhe të rinjve.
- Ka kryer hulumtimet ekzakte të faktorëve ekologjik të cilët ndikojnë në organizmin e njeriut, në veçanti në gjeneratën e re dhe ndikimi i saj në strukturën e popullatës.
- Ka hulumtuar format e mundshme të adaptimit të organizmit në kondita të caktuara gjeografike dhe socio-ekonomike të jetesës.
- Ka përcjellë interaksionin e rrethit (ambientit) i cili e rrethon organizmin e njeriut.
- Ka bërë vlerësimin e ndikimit të faktorëve gjenetik të cilët ndikojnë në rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve dhe të rinjve në popullatën e hulumtuar.

- Ka bërë përpunimine standardeve dhe normativave mbi statusin somatik të fëmijëve dhe të rinjëve të Pollogut.

Nga përfitimi i të dhënave për strukturën e karakteristikave morfologjike të fëmijëve dhe të rinjve do të mund të vlerësohet rritja dhe zhvillimi i nxënësve të niveleve të ndryshme edukativo-arsimore, gjithashtu rezultatet e fituara mund të shfrytëzohen në lëmi të ndryshme si: pedagogji dhe psikologji, pediatri, mjekësi ligjore, sporteve shkollore dhe higjienë, për aplikim në industri etj.

Pritjet shkencore nga hulumtimi

Rezultatet e të dhënave antropometrike në Rajonin e Pollogut (që përfshinë Tetovën dhe Gostivarin, në Maqedoninë veriperëndimore) do të jenë të rëndësishme si në aspektin shëndetësor poashtu edhe në aspektin shoqëror.

Përputhshmëria e rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve dhe të rinjve në Rajonin e Pollogut me vlerat referuese të rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve të përcaktuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë.

Vlerësimi i standardit jetësor, si një ndër faktorët kryesor që ndikon në rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve në popullatën e hulumtuar.

Ekzistimi i dallimeve eventuale në rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve në zonat urbane dhe rurale.

III. METODA E HULUMTIMIT

Tek „ **Materiali dhe metoda hulumtuese,** kandidati **Veton Ademi** paraqet në mënyrë të theksuar problematikën kryesore të metodologjisë hulumtuese të disertacionit të doktoraturës duke përshkruar në mënyrë decide metodologjinë kryesore të fushës së ngushtë të kësaj lëmie shkencore hulumtuese. Kandidati ka përdorur metodologjinë më bashkëkohore për hulumtim duke u bazuar në metodat më të përsosura për hulumtim të mirëfilltë të kësaj problematike hulumtuese shkencore.

Metodologjia e punës do të zhvillohet, si në hulumtimet në terren ashtu edhe në laboratore, sipas propozimit të Programit Internacional Biologjik (International Biologic Programme IBP, Nr. 9, 1969).

Gjatë realizimit të programit të hulumtimeve do të kryhen:

- Matjet në teren,
- Përpunimi statistikor i të dhënave,
- Analizimi dhe vërtetimi i të dhënave.

Karakteristi i hulumtimit është transversal, e ashtu quajtur "Cross-Sectional", në hulumtim do të përfshihen fëmijët e gjinisë mashkullore dhe femërore të moshës 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17 dhe 18 vjeçar. Numri i entiteteve për çdo grup moshë do të jetë 240 individ, 120 të gjinisë mashkullore dhe 120 të gjinisë femërore (*metoda përgjithësuese* - matjet antropometrike të një grupi të mjaftueshëm për çdo moshë që të mund të nxirren të dhëna të vlefshme për krahasim).

Për çdo të ekzaminuar do të formohet kartela antropologjike e cila përmbanë:

- të dhënat e përgjithshme për të ekzaminuarin dhe prindërit e tij,
- të dhënat kryesore më të rëndësishme antropometrike (27 parametra të cilat do të maten).

Hulumtimi do të kryhet në tërë popullatën e paraparë të përfshirë me këtë program.

Instrumentet antropometrike themelore të cilat do të përdoren janë: Peshorja, Antropometri, Stadiometri, Pelvimetri, Kefalometri, Vizorja rrëshqitëse (noniusi), Kaliperi, Shiriti për matje.

Për aplikimin e kësaj metodologjie dhe parametrave të vërtetuar antropometrik do të bëhet:

- Unifikimi i instrumenteve matëse antropologjike;
- Kalibrimi dhe verifikimi i instrumenteve të zgjedhur;
- Përdorimi i modeleve dhe tabelave të unifikuara;
- Përgaditja e personelit të cilët do të punojnë në hulumtimet në terren dhe marrjes së parametrave matëse dhe përshkruese.

Fusha shkencore e hulumtimit

Fusha shkencore e hulumtimit të kësaj teme është antropometria apo shkencë që merret me studimin e strukturës e trupit të njeriut, kryesisht nga aspekti kuantitativ. Thënë më saktë, një metodë e antropologjisë, e cila merret me matjen dhe hulumtimin e trupit të njeriut dhe me

marrëdhëniet midis madhësisë së trupit dhe pjesëve të caktuara të tij. Antropometria synon përshkrimin e tërësishëm të individit njerëzor dhe dëshirës që ta vështrojë si një tërësi psiko-fizike.

IV. REZULTATET DHE DISKUTIMI

Tek „ **Rezultatet,** kandidati **Veton Ademi** ka paraqitur dhe ka ilustruar në mënyrë tabelarësh, grafikonesh dhe figurave problematikën kryesore të fushës së ngushtë të kësaj lëmie shkencore hulumtuese. Rezultatet e fituara i ka shprehur në formë të ilustrimeve të qartësuara me vlera referente dhe vlera të fituar të cilat shprehin vlera determinante për diagnostifikimi e hershëm dhe të saktë të kësaj problematike.

Rezultatet e paraqitura nëpërmjet tabelave, grafikoneve dhe figurave janë të përpunuara me anë të metodologjisë më të sofistikuar *p value* dhe vlerave referente botërore. Këto rezultate do të japin një kontribut të çmuar për diagnostifikimin e sëmundjeve që janë të lidhura me sindromin metabolik dhe sidomos tek sëmundjet kardiovaskulare. Rezultatete fituara do ti shërbejnë fushës së mjekësisë në përgjithësi dhe fushës së kardiologjisë në veçanti.

Tek diskutimi kandidatja ka paraqitur në mënyrë shumë të detajuar problematikën e fushës hulumtuese dhe ka bërë krahasimin e rezultateve me shumë autor të vendit dhe sidomos me theks të veçantë potencojmë krahasimin e vlerave të kandidatës me vlerat referente të shume autoreve botëror që merren me problematikën e kësaj fushe hulumtuese.

Rezultatet tona pritet të tregojnë zhvillimin e fëmijëve në Rajonin e Pollogut në bazë të gjinisë dhe moshave të caktuara, të cilat janë shumë të rëndësishme si tregues për zhvillimin e fëmijëve, të cilat do të mund t'i krahasojmë me të dhënat e rajoneve tjera.

Gjithashtu, këta rezultate do të tregojnë nëse rritja dhe zhvillimi i fëmijëve në rajonin e pollogut është në nivel normal dhe në përputhje me vlerat referuese të rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve, të përcaktuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë.

Nëpërmjet këtyre rezultateve do të na jepet një pasqyrë e qartë nëse standardi jetësor është një ndër faktorët kryesor që ndikon në rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve në popullatën e hulumtuar. Do të shihet nëse ka dallime ndërmjet fëmijëve që jetojnë në zona urbane dhe rurale.

V. PËRFUNDIMI

Tek „ **Përfundimi,** kandidati **Veton Ademi** paraqet në mënyrë të thuktë problematikën kryesore dhe përfundimtare të tematikës së disertacionit të doktoraturës duke dhënë rekomandimet përfundimtare dhe finale të fushës së ngushtë të kësaj lëmie shkencore hulumtuese. Rezultatet e fituara kandidati gjithashtu i ka shprehur me ilustrime shumë decide për të sjellur konkudimet e duhura dhe të mirëfillëta për këtë fushë hulumtuese shkencore.

Rezultatet e fituara nga ky hulumtim, përveç rëndësisë së madhe fundamentale, kanë edhe rëndësi të madhe praktike në shumë lëmi si: pedagogji, psikologji, pediatri dhe higjienë shkollore për shkak të përcjelljes së rritjes dhe zhvillimit normal të fëmijëve dhe rinisë së rajonit të pollogut,

Mbi rëndësinë fundamentale ka shumë çka të diskutohet por për këtë rast do të theksojmë se sot vend qendror në antropologji i takon zhvillimit bashkëkohor biologjik i cili mund të përcillet dhe të studiohet në bazë të treguesëve të fituar antropologjik (rezultate të fituara antropologjike).

Të dhënat e fituara janë me rëndësi për përdorim në mbrojtjen popullore për shkak të njohjes së dinamikës së rritjes së njeriut tonë si dhe pështatjen ergonomike të makinave, mjeteve të punës, veshmbathjes në të gjitha vendet e veprimarisë së tij,

Të dhënat antropometrike mundësojnë qasjen e rregullt (normale) të pështatjes së njeriut në të gjitha vendet e veprimtarisë së tij.

Në aspekt të Shëndetit publik ndërmerenmasat terapeutike në përmisimin e rritjes dhe zhvillimit fizik sidhe psiqik dhe social.

Përpunimi i “normogramit të rritjes” për nevojat e praktikës mjekësore.

Rëndësia shëndetësore qëndron edhe në identifikimin e rasteve me mbipeshë dhe obezitet si faktorë të rëndësishëm në planifikimin dhe ndërmarrjen e masave parandaluese për pengimin e shfaqjes së shumë sëmundjeve që janë në lidhshmeri me mbipeshën dhe obezitetin. Këto sëmundje mund të shfaqen në moshën fëmijërore apo më vonë në moshën e rritur të këtyre fëmijëve si: diabet mellitus, çrregullime të shumta endokrinologjike, sëmundjet e zemrës dhe enëve të gjakut.

Në edukim dhe arsimim mundësojnë planifikimin normal dhe përcjelljen e të gjitha ngecjeve në pikëpamje të rritjes dhe zhvillimit e që identifikimi me kohë do të mundësonte përpunimin diagnostik me qëllim të identifikimit të shkaqeve të ndryshme që të ngecjes në rritje dhe zhvillim.

Në lëmitë e kulturës fizike mundësojnë seleksionimin, përcjelljen e zhvillimit dhe përmirsimin e aftësive trupore të individit dhe kolektivitetit.

Në industrinë e tekstit, konfeksionit, këpucëve dhe industrive tjera mundëson qasjen në masat antropometrike të rinisë të moshave të ndryshme, të të dy gjinive.

Në industrinë e mobiljeve dhe automobilave sigurojnë planifikimin e rregullt të dimensioneve të prodhimeve të tyre.

VI. BIBLIOGRAFIA

Tek „**Bibliografia**„ kandidati **Veton Ademi** paraqet në mënyrë të thuktë problematikën kryesore të tematikës së disertacionit të doktoraturës duke përkrahur dhe cituar literaturë përkatëse të fushës së ngushtë të kësaj lëmie shkencore hulumtuese.

Tek ky punim doktore do të fokusohet në literaturën më standarde dhe më bashkëkohore, në mënyrë të drejtë do të citohen referencat e punimit të doktoraturës. Këto referenca të cituara do të plotësojnë dhe do të japin një karakter edhe më përmbajtësorë punimit të doktoraturës sepse do të përkasin referencave më bashkëkohore të cituara me impakt ndërkombëtar, prandaj shihet edhe nga ky aspekt ky punim do të plotëson të gjitha standardet bashkëkohore të një punimi të mirëfilltë të doktoraturës.

Dukë u bazuar në të dhënat punimit të disertacioni të doktoraturës, konsiderojmë se ky punim i doktoraturës do të sjellë një risi në fushën antropologjisë në përgjithësi.

Ky punim në veçanti do të kontriboj në fushën e antropometrisë në veçanti dhe fushës së mjekësisë në përgjithësi, prandaj kërkojë nga **Këshilli Mësimor Shkencor të Fakultetit të Shkencave Mjekësore**, që ta miratojë punimin e disertacionit të doktoraturës të kandidatit **Veton Ademi** me titull: **“Karakteristikat antropometrike të fëmijëve dhe të të rinjve në rajonin e Pollogut”**,


Tetovë më, 27.01. 2020

Anëtarët e komisionit:

Prof. Dr. Sadi Bexheti




Prof. Dr. Nexhbedin Beadini



Prof. Dr. Nasir Bexheti



Prof. Dr. Kastriot Haxhirexha



Prof. Dr. Lutfi Zylbeari

